



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M
Nr. 81, date 26.12.2017

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE NË RAST FATKEQËSIE

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës 26.12.2017, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të neneve 40, 54 shkronja "dh", 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeversijen vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, ligjit nr. 130, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017", Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 2, datë 6.2.2012 "Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, Udhëzimin plotësues nr.8, datë 13.1.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017", VKB nr. 8, datë 30.1.2017 "Për buxhetin e vitit 2017 të Bashkisë Shkodër",

V E N D O S I

1. Miratimin e fondit prej 500,000 (pesëqind mijë) leke, për dhënie e ndihmës financiare për familjen e të ndjerit Florenc Gëzim Beqiraj, për fatkeqësinë familjare (vdekja e Florenc Beqiraj).
2. Institucionit të bashkisë Shkodër në programin buxhetor 10910 "Emergjencia civile" ti shtohet kundervlefata në leke e fondit prej 500,000 leke (pesëqind mije) shpenzime korrente, artikulli 606 "Transferta tek individet" për tu përdorur si ndihmë financiare për familjen e të ndjerit Florenc Beqiraj.
3. Burimi i financimit është fondi rezervë nga buxheti i bashkisë Shkodër sipas VKB nr. 8, datë 30.1.2017 "Për buxhetin e vitit 2017 të Bashkisë Shkodër".
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 26.12.2017

Shpallur në datën 26.12.2017

Sekretar i këshillit

Suel Hadri

KRYETAR

Xhemal BUSHATI